



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

15.10.2024

Tiranë më 15.10.2024 protdate.

Nr. 2878 protnumber

2878

**FTESË PËR NEGOCIATË  
PËR  
AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR PRODHIM I  
PRODUKSIONEVE AUDIO VIZUALE**

Në mbështetje, vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe vendimit nr. 172 datë. 03.09.2024 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, do të realizojë “Prodhimin e produksioneve audio vizuale” për materialet zgjedhore dhe materialet informuese.

**Objekti:** “Prodhimi i produksioneve audio vizuale”.

**Periudha e realizimit:** Realizimi i shërbimeve do të jetë 10 ditë nga kërkesat që do të vinë KQZ sipas tematikës së kërkuar.

**Fondi limit i përcaktuar:** fondi limit i procedurës është në vlerën *është 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.*

**Kohëzgjatja e kontratës:** deri më 31 dhjetor 2024

**Publikimi i ftesës për negociata:** 15 Tetor 2024

**Afati përfundimtar për paraqitjen e konfirmimeve nga media e shkruar/agjencia e specializuar është më datë 18 Tetor 2024 ora 16:00.**

**Konfirmimet për vazhdimin e negociatave:** Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në



zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 18 Tetor 2024 ora 16:00. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr.4

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

***Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Prodhimi i produksioneve audio vizuale", kriteret do të jenë si më poshtë.***

**Qëllimi i këtij shërbimi është:** Prodhimi i produksioneve audio vizuale me metrazh të shkurtër dhe të mesëm në funksion të informimit të zgjedhësve mbi aktivitetin e institucionit. Nisur nga rekomandimet e organizatave të huaja mbi edukimin e zgjedhësve, KQZ në planin e punës së saj ka planifikuar ndërgjegjësim dhe informin të zgjedhësve në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në pragë të periudhave zgjedhore me qëllim qasjen me familjare me proceset zgjedhore. Krijimi i videove promovuese, informuese, ose edukative të shkurtra me qëllim komunikimi të drejtpërdrejtë dhe i grafikave lëvizëse për të shpjeguar proceset zgjedhore ose për të ofruar udhëzime vizuale për publikun.

## **I. SHËRBIMET QË KËRKOHEN TË REALIZOHEN:**

1. Të realizojë kompozimin dhe prodhimin në produksioneve audio vizuale me karakter multimedial sipas porosisë së marrë nga autoriteti kontraktor.
2. Produksione Videografike me Metrazh të Shkurter. Krijimi i videove promovuese, informuese, ose edukative të shkurtra me qëllim komunikimi të drejtpërdrejtë. Përdorimi i kamerave me rezolucion të lartë (4K ose më shumë), ndriçim profesional, dhe editim dinamik me efekte vizuale.
3. Produksione Videografike me Metrazh të Mesëm. Videot e metrazhit të mesëm përfshijnë intervista, reportazhe, ose video instruktive. Kërkohet skenari i detajuar, përdorimi i pajisjeve të zërit me cilësi të lartë dhe montazhi me mbivendosje grafikësh informativë dhe animacion.
4. Masterizim i Videove. Përpunimi final i materialeve të filmuara për të siguruar cilësi maksimale audio dhe video. Përdoren teknika të ngjyrosjes (color grading), korrigjim i zërit, dhe balancimi i ndriçimit.
5. Xhirime me Dron. Shërbim i xhirimit ajror për të krijuar pamje dinamike të mjedisit dhe eventeve. Përdorimi i dronëve me stabilizim të avancuar dhe kamera me rezolucion të lartë për pamje nga lart.
6. Video Motion Graphics dhe Animacion 2D. Krijimi i grafikave lëvizëse për të shpjeguar proceset zgjedhore ose për të ofruar udhëzime vizuale për publikun. Përdoren mjete të avancuara si Adobe



- After Effects për të krijuar animacione dhe tranzicione të qarta.
7. Efekte Speciale Vizuale (VFX). Përfshirja e efekteve vizuale për të përmirësuar skena specifike, si mbivendosje tekstesh ose simulime të elementeve virtuale si harta ose statistika zgjedhore.
  8. Montazhi dhe Redaktimi i Materialeve të Xhiruara. Procesi i përzgjedhjes së pamjeve më të mira, prerja, dhe kombinimi i tyre për të krijuar një produkt të rrjedhshëm dhe koherent. Licencimi dhe përdorimi i programeve si Adobe Premiere Pro ose Final Cut Pro për përpunim të saktë të materialit.
  9. Korrigjim i Ngjyrave dhe Color Grading. Përdorimi i softuerëve të specializuar si DaVinci Resolve për të rregulluar dhe përmirësuar ngjyrat e videove për një pamje profesionale dhe uniforme.
  10. Inçizimi i Zërit në Vendngjarje. Përdorimi i mikrofonave shotgun dhe pajisjeve të zërit me frekuencë të lartë për regjistrim të qartë dhe të saktë të zërit, edhe në mjedise me zhurmë të jashtme.
  11. Dublimi dhe Zëvendësimi i Zërit (Voice-Over). Regjistrimi i zërit të përgatitur për të shoqëruar materialin vizual. Përdoret studio profesionale për të garantuar një cilësi të lartë të audios dhe për të sinkronizuar me pamjen.
  12. Subtitra në Gjuhë të Shumta. Përgatitja e titrave në disa gjuhë për të lehtësuar kuptimin e mesazhit nga audienca ndërkombëtare. Përfshin sinkronizimin e saktë me audio dhe përkthime të sakta.
  13. Krijimi i Trailerëve dhe Promove. Montimi i skenave më të mira për krijimin e trailerëve të shkurtër që shfaqin thelbin e një eventi apo një materiali më të gjatë. Kjo përfshin efekte të sinkronizuara me muzikën dhe tekstet.
  14. Grafikë 3D dhe Animacion 3D. Përdorimi i teknologjisë 3D për të krijuar modele virtuale ose për të simuluar objekte dhe skena që nuk mund të xhirohen fizikisht. Përdorimi i mjeteve si Blender apo Cinema 4D.
  15. Video Multicam (Xhirime me disa Kamera). Xhirime nga disa kënde të një eventi duke përdorur disa kamera për të kapur pamje të ndryshme dhe për të krijuar një montazh dinamik me shumë perspektiva.
  16. Përpunim dhe Sinkronizim i Zërit. Përdorimi i softuerëve si Adobe Audition për të përmirësuar dhe sinkronizuar zërin me pamjet vizuale, përfshirë reduktimin e zhurmave të jashtme dhe balancimin e frekuencave audio.
  17. Krijimi i Reklamave Video për Media Sociale. Përgatitja e videove specifike për platformat e mediave sociale (Facebook, Instagram, YouTube), duke optimizuar formatin dhe kohëzgjatjen për performancë të lartë.
  18. Arkivim dhe Ruajtje e Materialeve. Organizimi dhe ruajtja e materialeve të xhiruara në formate të ndryshme (RAW, MP4, MOV) në serverë të sigurtë dhe rentim platforma cloud për akses të lehtë në të ardhmen.
  19. Video të Drejtpërdrejta Live Streaming. Përdorimi i pajisjeve të specializuara për transmetime të drejtpërdrejta me cilësi të lartë të eventeve zgjedhore. Përdoren encodera të dedikuara dhe lidhje interneti me kapacitet të lartë për transmetim pa ndërprerje.



20. Postproduksion i Zhvilluar për Transmetime Televizive. Përgatitja e videove për standardet e transmetimit televiziv, duke përfshirë kompresionin e saktë të skedarëve, formatet e pranueshme (HD/4K), dhe futja e grafikave të standardizuara për ekran.
21. Menaxhimi dhe Konsulenca për Prodhime Videografike. Shërbime konsulence për organizimin e të gjitha fazave të produksionit, nga planifikimi fillestar deri te dorëzimi final. Suport teknik për skenarë, kohëzgjatje, dhe menaxhimin e burimeve.

## II. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

1. është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
2. nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
4. personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
5. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
6. nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
7. ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
8. nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
9. ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
10. kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

*Shënim: Për plotësimin e kërkesave të mësipërme mund ti paraqesim më vetdeklarim dhe përpara fazës së shpalljes së fituesit përfundimtar, shoqëria e renditur e para më pikë do të sjellë dokumentacionin provues.*



### III. KRITERET E VECANTA TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
  - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*
  - *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*
2. Ofeta ekonomike: Operatorët do të duhen të paraqesin ofertën ekonomike të detajuar sipas 5 zerave të shërbimit të paraqitur më sipër në vlerën pa tvsh dhe me tvsh.
3. Operatorët ekonomik do të paraqesin një project ide/ zgjidhje teknike/ propozim për realizmin e shërbime që kërkohen.

#### A- KRITERET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i ofertës ekonomike më të favorshme sipas pikëzimit të mëposhtëm:

- **Kriteret e përgjithshme:** 20 pikë
- **Oferta financiare** 50 pikë
- **Zgjedhja teknike/propozimin për realizmin e shërbimit (project ideja)** 30 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)